



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 3919 prot.

Tiranë, më 05.09.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.908, datë 01.09.2005.

**SHOQËRISË “AGIBES HALILI” SH.P.K
Rruga “Abdyl Frashëri”, Pallati 11/1, kati 7, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA**

Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “AGIBES HALILI” sh.p.k ishte zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.908, datë 01.09.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtish Tufinë”, Tiranë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.4988, datë 18.05.2018, “Njoftim për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur gjatë shfrytëzimit”, dërguar për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.7651, datë 21.05.2018, kërkohet rehabilitimi i sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi i lejes në fjalë.

Leja ishte dhënë me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, afat vlefshmërie 10 vite, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 57, pika 2, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, thuhet se:

“2. Për të drejtat minerare të fituara në bazë të Ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, “Ligji minerar i Shqipërisë”, i ndryshuar, sipërfaqja e zonës së lejuar dhe afati i miratuar nuk ndryshojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, deri në përfundim të afatit të miratuar. Aplikimi për shtyrje afati kryhet në përputhje me këtë ligj”.

Në pikën nr.6, të nenit 24, të Ligjit të sipërcituar thuhet se: “Leja e shfrytëzimit e grupit të mineraleve ndërtimore ka afat vlefshmërie, jo më të gjatë se 25 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe është subjekt i një shtese, deri në 10 vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohej nga zotëruesi i lejes, të paktën, 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë. Afati i aplikimit është prekluziv dhe me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit”.

Shoqëria “AGIBES HALILI” sh.p.k në përputhje me bazën ligjore që cituam më lart, kishte aplikuar me numër çështje LC – 1270 – 02 – 2015, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për shtyrje afati të lejes minerare nr.908, datë 01.09.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtish Tufinë”, Tiranë, duke respektuar afatin ligjor.

Nga verifikimet në GIS, bazuar në aktet ligjore për Zonat e Mbrojtura në Territorin e Shqipërisë, rezultoi se, zona ku keni ushtruar aktivitet minerar ndodhet brenda Zonës së Mbrojtur, përcaktuar në VKM-në Nr.402, datë 21.06.2006, “Për shpalljen e Ekosistemit Natyror të Malit të Dajtit, Park Kombëtar ” .

Në zbatim të germave “a” dhe “b”, të pikës nr.2, të nenit 16 (Parku kombëtar, Kategoria II-të), të Ligjit nr.81/2017, datë 04.05.2017, “Për zonat e mbrojtura”, nuk lejohet zhvillimi i aktivitetit minerar, brenda Zonës së Mbrojtur.

Sa thamë më sipër, kërkesa e shoqërisë “AGIBES HALILI” sh.p.k, për zgjatje afati nuk plotësonte kushtet e lejimit, sipas dokumentacionit vërtetues të paraqitur nga subjekti, për të vijuar procedurat e shtyrjes së afatit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.908, datë 01.09.2005, në objektin e gurit gëlqeror, për shkaqet që trajtuam më sipër.

Sipas germës “h”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë krijuar shkaqet ligjore për revokimin e lejes nr.908, datë 01.09.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtish Tufinë”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.908, datë 01.09.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtish Tufinë” Tiranë**, që shoqëria juaj zotëronte.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.908, datë 01.09.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtish Tufinë”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTA

